

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje dru zjarri per ngrohje

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

03413000-8, dru zjarri

VLERA E FONDIT LIMIT:

3.332.000 (tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë)lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vau Dejës(njësia e prokurimit)**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

Ne Shumen 66.640 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet) lek.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shprehje ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Marzhi i vlerës së xhiros të kërkuar është vlerësuar në 40%, pasi mendojmë që është një vlerë e cila e garanton AK për kapacitetin dhe eksperiencën e OE në përmbushjen e kontratës dhe gjithashtu nxit pjesëmarrjen e OE në procedurë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. *(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë

bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet te kete numrin e nevojshem per 2 (dy) punonjes te siguruar per zbatimin e kontrates.

- a) Kjo te deshmoget me vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguruar (**Formulari E-SIG 02/a**) te shoqerohet me formularet E-SIG 025/a.

(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.4.2 Operatoret ekonomike duhet te paraqesin nje **Deklarate**, qe 30% te sasise se druve te zjarrit e kanë në gjendje te magazinuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar .

2.4.3.Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik. Kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete pune.

<i>1. Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Mjet transporti</i>	<i>cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë mjetet e mësipërme në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për mjetete sipërcituara dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).

b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), certifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qirase/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike kur janë në pronësi duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si kontratën e blerjes ose dokumentin e çdoganimit, faturat, ndërsa kur janë marrë me qira, kontratë qiraje, fatura tatimore.

d) Për secilin nga mjetet e kërkuara të paraqiten foto ku të jete e dukshme targat e mjeteve.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i makinerive, në pronësi / qira / kontratë furnizimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetëve të tjera fizike, aftësitë organizative. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet sipas specifikave.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga njesia e prokurimit mbështetur në kontratat e ngjashme, në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenin 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

1. Skicimet, parametrat teknik:

- Drute e zjarrit të jete të çara mbi 10 cm diametër e lart, dhe të shkurtuar 25-30 cm të gatshme për një stufë ngrohje

2. Specifikimi i Materialeve:

Malli (dru zjarri) i ofruar nga operatori ekonomik, duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Drute e zjarri te jene te grupit te llojeve pyjore te forta si: Ah&Dushku dhe jo ne grupin e llojeve te buta si :Bredh, shelig, Plep apo Verrij
- Drutë e Zjarrit kur te dorezohen, te maten te stivosura ,dhe te inventarizohen sipas standarteve ne meter stere (mst)
- Materiali i druve te zjarrit mos te jenë te dekompozuar (te kalbura dhe te djegura)

3. Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Drute duhet te dorezohen prane magazines se Bashkise Vau Dejes (sipas kerkesave), dhe te sistemohen me qellim matjen e tyre.
- Drutë duhet te jene te stivosura ne objekt dhe do te merren ne dorezim sipas kerkeses së AK-se, brenda orarit zyrtar te punes dhe jo ne dite pushimi apo festash zyrtare.
- Furnizimi do te behet nga kontraktuesi me automjetin e tij nga pika e furnizimit deri ne destinacion.
- Ne rast se malli objekt prokurimi (dru zjarri) nuk ploteson kerkesat dhe standardet teknike, nuk do te merret ne dorezim.

Specifikimet teknike të mallrave janë vendosur bazuar në eksperiencën e mëparshme të bashkisë Vau Dejës si dhe në eksperiencën e AK-ve të tjera në këto lloj procedurash.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e njaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT